

Mark Krasniqi

## DISA VEÇORI ETNOGRAFIKE TË LUGUT TË BARANIT

(Familja — fisi — bajraku — katundi)

### Kushtet shoqërore-ekonomike

Lugu i Baranit është një zonë e vogël etnografike në pjesën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, e cila shtrihet gjatë lugut të Bistricës së Deçanit duke filluar nga fshati Kryshec e deri në fshatin Kpuz në bregun e djathtë të Drinit të Bardhë. Në këtë zonë bëjnë pjesë 15 fshatra, të cilat rreshtohen në këtë mënyrë, duke u nisur nga perëndimi në drejtim të lindjes: Krysheci, Broliqi, Rashiqi, Kodradiqi, Turjaka, Barani, Çellopeku, Vranoci, Buqani, Kosuriqi, Llugagjija, Glllogjani, Nepolja, Çeskova dhe Kpuzi. Barani, në disa raste, merret si dy fshatra — Barani i Epërm dhe Barani i Poshtëm, por në dokumentet, zyrtare dhe në statistikë figuron si një fshat. Shumica e fshatrave janë në pjesën fushore të kësaj zone, kurse Kpuzi, Çeskova dhe Turjaka (pjesërisht edhe Krysheci) janë në pjesën kodrinore. Sipas regjistrimit të popullsisë në mars 1981, në këto 15 fshatra kanë jetuar 11224 banorë, përkatësisht 10702 shqiptarë (95,35%), 413 malazet (3,67%), 75 (0,66%) myslimanë (me kombësi), 25 (0,22%) serbë dhe 5 (0,04%) të tjerë.<sup>1</sup> Sipas këtyre të dhënave statistikore, më 1981 Lugu i Baranit ka pasur 1100 shtëpi (familje), kurse 440 banorë kanë qenë në punë të përkohshme në botën e jashtme (në vendet e Evropës Perëndimore); një numër fare i vogël kanë qenë në punë në shkollat fillore dhe në dyqane të këtyre fshatrave ose në Pejë, kështu që më se 95% e popullsisë është marrë vetëm me bujqësi. Dendësia agrare këtu është mjaft e madhe, sepse për një banor bie më pak se 25 ari tokë pjellore. Përveç kësaj, bujqësia është mjaft ekstenzive, kështu që edhe rendimentet janë të vogla. Prandaj shumica e fshatarëve nuk mund ta sigurojnë bukën e motmotit nga pronat e tyre të vogla. Pas luftës të gjitha fshatrat janë elektrifikuar, janë hapur disa shkolla fillore dhe është asfaltuar rruga prej Glllogjani deri në Raushiq, ku kjo lidhet me rrugën Pejë — Gjakovë.

<sup>1</sup> Enti Krahinor i Statistikës, *Buletin*, nr. 14, Prishtinë, korrik, 1981, 39—41.

Për historinë e lashtë të kësaj zone nuk kemi të dhëna më të hollësishme, sepse këtu nuk janë bërë deri më tash gërmime arkeologjike, megjithëse para pak vitesh në fshatin Vranoc janë gjetur disa vegla prej guri (sëpata, thika etj.) nga periudha e neolitit.<sup>2</sup> Disa fshatra të Lugut të Baranit përmenden qysh nga fillimi i shekullit XIV si pronë të manastirit të Deçanit, ose të manastirit të Hilandarit në Greqi.<sup>3</sup> Të dhëna të rëndësishme mbi gjendjen shoqërore-ekonomike të kësaj zone përmban Deferi i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, ku përmenden shumica e fshatrave që ekzistojnë edhe sot.<sup>4</sup> Këto dokumente historike kanë rëndësinë e tyre edhe nga aspekti i shkencës etnografike, sepse nga ato shihet struktura sociale, kombëtare dhe fetare e popullsisë, e cila qysh atëherë ka qenë e përzier — sllave e shqiptare, ortodokse e katolike, madje edhe muslimane në disa raste, kurse të gjithë së bashku kanë qenë bujkrobër të varfër e të eksploatuar, qoftë nga kisha, qoftë nga spahiu.

Për periudhën nga mbarimi i shekullit XV e deri në shekullin XIX nuk kemi të dhëna të shkruara konkretisht për Lugun e Baranit. Mirëpo, dihet se rrethanat shoqërore-politike gjatë kësaj periudhe kanë qenë të njëjta në mbarë Dukagjinin, madje në Kosovë në përgjithësi. Kjo periudhë mban vulën e përgjithshme të marrëdhënieve feudale në fshat. Kuptohet se kjo gjendje ka qenë shumë e vështirë, kështu që fshatarët e këtyre viseve ngriheshin edhe në mënyrë të organizuar kundër pushtetit turk. Kundër gjendjes së tillë fshatarët e rrethit të Pejës, pra edhe të Lugut të Baranit, bënë kryengritje më 1560, me Pjetër Bogdanin (Plakun) në krye, i cili ka qenë nga fshati Dush. Po në këto vise fshatarët çojnë krye edhe më 1580, 1788 etj. Madje, këta gëzonin përkrahjen edhe të disa pronarëve të tokave nga qyteti, të qehallarëve etj., të pakënaqur me pushtetin turk. Në një raport dërguar Portës së Lartë nga zyrtarët e këtyre viseve më 1588 thuhet se edhe vojvoda i Sanxhakut të Dukagjinit, Idrisi, si dhe personi i quajtur Ali Curri, „bëhen udhëheqës — prijatarë të disa kryengritësve”. Në një raport të Pjetër Budit, dërguar papës në Romë më 1620, përveç të tjerave, thuhet se popullsia e krahinës së Dukagjinit, e cila pareshtur është në kryengritje kundër turqve, ka 6000 njerëz të aftë për luftë.<sup>5</sup> Në luftën austro-turke më 1690, siç dihet, morën pjesë në anën e ushtrisë austriake disa mija vullnetarë shqiptarë, në krye me argjipeshkivin e Shkupit Pjetër Bogdani, bashkë me vullnetarët serbë, të cilëve u

<sup>2</sup> Fejaz Drançolli, *Burime materiale me elemente autoktone*, Rilindja, 20. XII 1982, Prishtinë.

<sup>3</sup> Pavle Ivić — Milica Grković, *Deçanske hrisovulje*, Novi Sad, 1976, 157, 196, 197; Skendër Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, 232.

<sup>4</sup> Selami Pulaha, *Deferi i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1974.

<sup>5</sup> Skendër Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, 481, 482, 492.

printe patriku i Pejës Arsenije Çarnojeviqi. Numri i vullnetarëve shqiptarë ka qenë i madh sidomos nga rrethinat e Pejës, siç dëshmon edhe një dokument i asaj kohe ku thuhet „3000 kryengritës shqiptarë e muarën kasabën e Pejës”.<sup>6</sup> Në këtë luftë humbën jetën shumë njerëz, por më shumë vdiqën nga epidemia e murtajës, e cila u shfaq në atë kohë. Në disa fshatra të Lugut të Baranit edhe sot përmeden „vorret e hasallakut”, ku, sipas traditës, janë varrosur viktimat e kolerës në kohën e luftës në fjalë.

Kah fundi i shekullit XVII, sipas traditës, pushteti turk krijon organizatën e bajrakut në Lug të Baranit, sepse disa banorë të kësaj treve kanë marrë pjesë në Luftën e Moresë (1684), në të cilën janë dalluar për trimëri. Më vonë, popullsia e kësaj zone ka marrë pjesë në lëvizjen nacionalçlirimtare të Lidhjes së Prizrenit (1878—1881), në luftimet e vitit 1893 kundër pushtetit osman, të cilat i udhëniqte Haxhi Zeka, si edhe në kryengritjen e vitit 1911 dhe 1912 për çlirimin kombëtar.<sup>7</sup> Gjatë Luftës Ballkanike (1912—1913) Lugu i Baranit ka pësuar shumë nga terrori i ushtrisë dhe i gjindarmërisë së krajl Nikollës, sidomos në pranverën e vitit 1913, kur popullsia e kësaj zone ka qenë e detyruar të ndërrojë fenë dhe kombësinë. Me gjithë viktimat që i pësoi ajo nuk u perul, por i rezistoi kësaj dhune, e cila ushtrohej edhe në zona të tjera të Dukagjinit.

Periudha midis dy luftërave të kaluara botërore (1918—1941) ka qenë periudhë e shtypjes dhe e shfrytëzimit të masava popullore nga ana e regjimit borgjez të Mbretërisë së Jugosllavisë. Gjendja e shqiptarëve në atë kohë ka qenë tepër e vështirë, sepse qeveria borgjeze ka pasur për qëllim zhdukjen e shqiptarëve nga trojet e tyre, dëbimin e tyre për në Turqi, asimilimin kombëtar me masa të ndryshme, kështu që ata nuk gëzonin të drejtat elementare qytetare në atë shtet.<sup>8</sup> Për t’ia arritur qëllimit, qeveria ua merrte edhe tokën fshatarëve të varfër shqiptarë dhe këtë ua jepte kolonistëve („naselenikëve”) nga Mali i Zi, Serbia, Lika etj. Deri në fund të vitit 1939 vetëm në rrethin e Pejës qeveria i ka vendosur 7972 kolonistë, kurse në Llap deri më 1918 (sipas të dhënave zyrtare të qeverisë së Jugosllavisë borgjeze) nuk ka pasur asnjë familje sllave. Me kolonizimin e kësaj zone në këtë kohë, popullsia sllave kishte arritur 12,5% të popullsisë së saj.<sup>9</sup> E tillë ka qenë situata edhe në Lug të Baranit. Madje, këtu, si edhe në disa vise të tjera, qevria dërgonte njerëz të

<sup>6</sup> *Po aty*, 512.

<sup>7</sup> Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës 1878—1912*, Prishtinë, 1969, 81—83.

<sup>8</sup> Hakif Bajrami: *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918—1941*, Prishtinë, 1981, 1—500; Kosta Novaković, *Kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës*, Liria Kombëtare, Vjenë, 15. IX 1931; Ali Hadri, *Marrëdhëniet agrare dhe lufta e PKJ në Kosovë-Metohi kundër reformës agrare të padrejtë të Jugosllavisë borgjeze*, Përparimi, nr. 9—10, Prishtinë, 1964.

<sup>9</sup> Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918—1941)*, Priština, 1981, 223, 224.

paguar për të bërë propagandë ndër fshatarë që të shpërngulen sa më shumë, duke thënë se „Turqia është shteti i myslimanëve dhe se atje është xhenet i vërtetë për besimtarët e Muhamedit”. Nga ana tjetër, „naçallniku” (prefekti) i Pejës shumë familjeve në Vranoc, Baran etj. u kishte vënë në dorë të oborrit urdhëresa të rrepta që të shpërngulen brenda disa ditësh. Por, me gjithë terrorin e hapët (vrasje, burgime dhe marrjen e tokës) prapë asnjë familje nga Lugu i Baranit nuk shpërngulet për në Turqi.

Popullsia shqiptare ka pasur përkrahjen morale nga PKJ, e cila edhe vetë ka qenë e ndjekur, sepse luftonte politikisht kundër qeverisë dhe sistemit borgjez dhe propogante barazinë kombëtare e sociale. Nga ana tjetër, Lëvizja e Kaçakëve shqiptarë ka qenë një mbështetje e fortë në kohët më të vështira, sepse kaçakët luftonin me armë në dorë kundër gjindarmërisë dhe ushtrisë së krajlit, e cila shpeshherë bënte terror të madh në poullsinë e pafajshme.<sup>10</sup>

Fshatarët e kundërshtonin politikën e qeverisë antipopullore në shumë raste, por ngjarja në shkurt të vitit 1937, që u zhvillua në Baran, do të mbetet në historinë e kësaj treve si dëshmi e shpirtit revolucionar të popullsisë së saj. Madje, me rastin e votimeve për kryetar të komunës, përkatësisht për deputet, gjindarmëria dhe organet e tjera të pushtetit të ardhura nga Peja, i falsifikuan rezultatet e votimeve, sepse ato nuk ishin në favor të kandidatit të qeverisë. Fshatarët kundërshtuan duke depërtuar në zyrat e komunës dhe u përleshën me gjindarmëri, edhe pse të gjithë ishin duarthatë. Gjindarmët hapën zjarr dhe kështu u vranë e u plagosën më se 30 fshatarë.<sup>11</sup>

Këto shënime të shkurtra mbi të kaluarën e Lugut të aBranit i dhamë këtu për arsye se kanë ndikuar në aspekte të ndryshme të jetës së popullsisë së kësaj zone, madje edhe në kulturën e saj tradicionale, në organizimin shoqëror, në arkitekturën popullore, në folklor, në solidaritetin e fshatit si edhe në botëkuptimin e njerëzve. Në botëkuptimin e njeriut, në ndërgegjen e tij, siç dihet, ndikim dominant ka puna, përkatësisht mënyra e prodhimit. Popullsia e Lugut të Baranit është më se 95% popullsi bujqësore, mjaft e varfër, sepse ka pak tokë pjellore, kështu që edhe në botëkuptimin e këtyre njerëzve, në vetëdijen e tyre, reflektohen gjithmonë problemet e prodhimtarisë bujqësore, përkatësisht toka, kushtet klimatike, ujitja, rendimenti, bagëtia dhe shumë probleme të tjera të këtij lloji. Prandaj, fshatari patriarkal dhe i pashkolluar ka qenë gjithmonë i ngarkuar me besime e bestytni të ndryshme, të cilat ai i ushtronte me shpresë se ara do të japë më shumë drithë, lopa më shumë viça dhe kopshti më shumë fruta.

<sup>10</sup> Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918—1928)*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1981, 1—267.

<sup>11</sup> Momčilo Hajduković, *Četrdesetogodišnjica Prve Oblasne konferencije KPJ za Kosovo i Metohiju*, Letak protiv nasilja, Politika, Beograd, 25. VI 1977.

### Familja, fisi, bajraku, katundi

Organizimi i jetës shoqërore dhe familjare në popullsinë e viseve të ndryshme të Kosovës, si edhe në Shqipërinë e veriut, është shumë i ngjashëm, madje në shumë raste edhe identik, por, kuptohet, ekzistojnë edhe nuanca dhe elemente të ndryshme me të cilat zonat e ndryshme etnogjeografike veçohen. Disa veçori të kësaj natyre i hasim edhe në Lugun e Baranit.

**F a m i l j a.** — Deri pas Luftës së Dytë Botërore familja shqiptare në përgjithësi në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në rrethinat e Preshevës, të Bujanovcit dhe në Jabllanicën e Leskocit ka qenë patriarkale, kështu që kryefamiljari, burri dhe në përgjithësi mashkulli, ka pasur gjithë pushtetin në dorë, kurse gruaja nuk pyetej për kurrgjë, sepse ajo ka qenë e varur ekonomikisht nga burri dhe normat e traditës nuk lejonin emancipimin e saj. Kushtet e atëhershme shoqërore kanë qenë faktori kryesor, që stimulonin gjendjen nënshtruese të gruas. E tillë ka qenë gjendja e përgjithshme e familjes shqiptare në Jugosllavinë borgjeze.

Pas luftës, në kushtet e reja shoqërore, edhe familja shqiptare filloi të ndryshojë disa tipare të saj tradicionale, si pasojë e proklamimit zyrtar të barazisë së gruas me mashkullin, por më tepër edhe si rezultat i shkollimit të saj e të burrit dhe të emancipimit ekonomik.<sup>12</sup> Me këtë rast nuk do të ndalemi në shqyrtimin e karakteristikave të përgjithshme të familjes, të cilat janë të përbashkëta edhe në familjen e Lugut të Baranit, por do ta shqyrtojmë këtë institucion nga aspekti i disa veçorive me të cilat ajo paraqitet në këtë zonë etno-gjeografike.

Deri para disa vjetësh numri i familjeve të mëdha patriarkale në Lug të Baranit nuk ka qenë i vogël, megjithëse kushtet e reja pas lufte imponojnë shtuarjen e tyre të shpejtë. Në këtë trevë kjo ka pasur jetë më të gjatë para së gjithash për arsye të kushteve ekonomike, përkatësisht të mungesës së tokës pjellore. Bujqësia, si e thamë edhe më lart, është puna kryesore, me të cilën merren më se 95% të popullsisë dhe se për kokë të banorit bie më pak se 25 ari. Mirëpo, kur familjet jetojnë në kolektive më të mëdha, atëherë kanë 3—5 ha tokë dhe kështu disi mund të kalohej. Por nëse familja ndahej në disa pjesë, atëherë ato do të posedonin vetëm nga 1 ha ose pak më shumë, por në disa raste edhe më pak. Mirëpo, në këto dhjetë vjetët e fundit, kur njerëzit edhe nga kjo zonë filluan të shkojnë me një numër më të madh në punë të përkohshme në botën e jashtme ose të gjejnë punë në qytete të ndryshme të Kosovës e të vendit në përgjithësi, atëherë edhe familjet filluan të shturen më shpejt, sepse disa pjesëtarë të saj fituan kështu pavarësinë ekonomike. Deri më 1971 familja më e madhe në këtë trevë ka qenë ajo e Tahir

<sup>12</sup> Mark Krasniqi, *Familja e madhe patriarkale në Kosovë*, Gjurmë e Gjurmime — Studime etnografike — Prishtinë, 1979, 197—236.

Smajlit në fshatin Nepole me më se 45 pjesëtarë. Familjet e mëdha përbëhen, siç dihet, nga disa kurora, nga vëllezërit dhe kushërinjtë të martuar dhe fëmijët e tyre. Këtu, për familje të tilla shpeshherë dëgjohet termi „familje shumë hisesh”. Kjo do të thotë se në rast se familja e tillë ndahet, toka dhe pasuria tjetër duhet të ndahet në shumë pjesë, përkatësisht në aq pjesë sa ka vëllezër e kushërinj. Në raste konkrete thuhet „familje 2 (ose më shumë) hisesh”.

Një veçori tjetër është „tipi i familjes së ndarë”. Familjet e tilla krijojnë një bashkësi familjare dhe ekonomike, por ato jetojnë të ndara — në dy fshatra të largëta ku kanë tokën dhe bagëtinë. Megjithatë, ato kanë një kryefamiljar të përbashkët, i cili zakonisht ka një zëvendës, kur ai vetë nuk është i pranishëm. Këto familje krijoheshin në ato raste kur pjesëtarët e tyre rriteshin, përkatësisht kur numri i tyre shtohet aq shumë sa që nuk mund të jetonin nga prona të cilën e kishin në dispozicion. Atëherë blenin tokë ku të gjenin, dhe atje kalonte një pjesë e anëtarëve të saj. Me kohë, sidomos pas luftës, këto ndaheshin dhe zakonisht secila pjesë mbetej atje ku ndodhej. Kështu në katundin Kosuriq deri në ditët tona jetonte familja e madhe Panxha, e cila përbëhej nga dy pjesë: një pjesë e saj jetonte në Kosuriq kurse pjesa tjetër në Voksh, prej nga kishte ardhur në Kosuriq, sepse në Voksh në përgjithësi ka pak tokë pjellore. Kryefamiljari ka pasur dy gra, njërin e mbante në Voksh e tjetrën në Kosuriq. E tillë ka qenë edhe familja e Rrustem Alisë, një pjesë e së cilës jetonte në Baran, kurse pjesa tjetër në Llukë të Epërme. Edhe kjo është ndarë në dy pjesë aty kah viti 1950. Familje të tilla të ndara të dy pjesë (por që megjithatë ishin një bashkësi familjare) ka pasur edhe në dsia fshatra të tjera të afërme, si p.sh. në Isniq, në Strelle, e sidomos në Rugovë.

Familja e madhe patriarkale në Lug të Baranit ka qenë kushtëzuar edhe nga rritja e madhe e popullsisë. Kjo shihet nga fakti se më 1971 numri mesatar i pjesëtarëve në çdo familje ka qenë 9,4. Dhjetë vjet më vonë (më 1981) kjo mesatare ka qenë 10,2 pjesëtarë për familje. Në këtë vit mesatarja e Kosovës ka qenë 6,90, kurse mesatarja jugosllave 3,30. Pra, si shihet, mesatarja e numrit të pjesëtarëve të familjes në këtë zonë ka qenë shumë më e madhe se mesatarja e Kosovës dhe 3 herë më e madhe se mesatarja jugosllave.

Në Lug të Baranit ka pasur deri në ditët tona familje të përziera myslimane e katolike, kështu që një pjesë e njerëzve të familjes ishin myslimanë, kurse pjesa tjetër katolikë. Të gjithë këta kanë qenë kushërinj të parë, kështu që përta i përket lidhmërisë me gjini gjaku ndërmjet pjesëtarëve, nuk ka pasur kurrfarë dallimi nga familjet e tjera të një besimi. Dikur, para shumë shekujsh, kjo dukuri ka qenë e zakonshme jo vetëm këtu, por edhe në vise të tjera të Kosovës dhe jashtë saj. Kështu, p.sh., arqipeshkvi dhe autori i njohur Pjetër Mazreku, në raportin e tij dërguar papës në Romë më 1621 mbi gjendjen e kishës katolike në Ballkan shkruan se në Suharekë dhe në shumë katunde të tjera të këtyre viseve, meshkujt kanë qenë të detyruar me presione e dhunë të ndryshme nga pushteti turk,

të kalojnë në fenë myslimane. Mirëpo, gratë e fëmijët e tyre edhe një kohë të gjatë kanë qëndruar në fenë katolike.<sup>13</sup> Edhe më herët këtu kanë ekzistuar familje të përziera nga aspekti fetar, madje në familje të tilla shqiptare ka pasur pjesëtarë të fesë katolike dhe të fesë ortodokse. Kjo shihet qartë nga defteri turk i vitit 1485, i cili përmban regjistrin e të gjitha familjeve me emrin e mbiemrin e kryefamiljarit. Kështu, p.sh., në fshatin Kryshec të kësaj treve, përveç emrave sllavë të kryefamiljarëve, shënohen edhe ata me emra shqiptarë: Gjergji, i biri Dimitrit, Branko, i vëllai i Gjonit, Gjorgji, i biri i Ajo Prendit, Bozhidari, i biri Nushës dhe Radosavi, i biri i tij etj. Në Kosuriq në këtë defter përmendet edhe Nikolla, i biri i Nikës, Kragui, i biri i Prenkut, pastaj në Baran të Poshtëm — Bogdani, i biri i Plakut, në Baran të Epërm — Prebili, i biri i Gjonit dhe kështu me radhë.<sup>14</sup> Shumë emra të këtyre familjarë gjenden në defterin e vitit 1485 edhe në një numër të madh katundesh të Dukagjinit. Nga kjo shihet se edhe shqiptarët në atë kohë kanë pasur shumë emra sllavë, gjë që ka rrjedhur nga ndikimi i kishtës ortodokse, përkatësisht nga presioni i patrikut të Pejës, i cili ka pasur autorizime të mëdha për të sunduar mbi të gjithë të krishterët e këtyre viseve, pa marrë parasysh a janë ortodoksë ose katolikë.

Raportet e priftërinjve katolikë dërguar papës në Romë, dëshmojnë se katolikët shqiptarë të këtyre viseve kanë qenë në hall më të madh nga kisha ortodokse serbe se nga pushteti turk dhe se nga zullumi i tillë shumë nga këta kanë filluar të kalojnë në fenë ortodokse.<sup>15</sup> Edhe sot ka familje shqiptare me emra sllavë në Pejë e në rrethinat e saj (Bozhë, Gjurë, Milan etj.), kurse në Mal të Zi numri i tyre nuk është i vogël. Pra, emri ndër shqiptarët nuk përcakton gjithmonë edhe kombësinë e tyre, sepse këta jo rallë mbajnë emra të huaj (sllavë, grekë, romakë) ose arabë (Hasan, Hysen, Adem, Fazli etj). Kështu duhet shpjeguar edhe emri i familjes Rajku në Dubovikë, Stojku në Buqan, Stepan në Junik etj. Madje, në defterin turk të vitit 1485 thuhet shprehimisht për një kryefamiljar në Junik — „Stepani, i biri i Lekës”, kurse në disa fshatra të tjera përmendet në këtë dokument „Drago Arbanasi”, „Bogdan Shqiptari”, „Radiq Krasniqi” „Miha, i biri i Arbanasit” etj.<sup>16</sup> Defteri turk i vitit 1485, si edhe një defter tjetër i vitit 1582, bashkë me dokumentet e tjera historike, hedhin poshtë tezën e njohur të disa historianëve borgjezë se gjoja shqiptarët kanë filluar të vijnë e të ngulen në Kosovë vetëm pas luftës austro-turke më 1690.

<sup>13</sup> E. Fermentžin, *Isprave godine 1579—1671 tičuće se Crne Gore i Stare Srbije*, Starine Jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti, XXV, Zagreb, 1892, 173.

<sup>14</sup> S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit...*, 290, 291.

<sup>15</sup> Jovan Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI—XIX veka*, Srpska akademija nauka, Beograd, 1950, 340-343, 347.

<sup>16</sup> S. Pulaha, *Elementi shqiptar sipas onomastikës së krahinave të Sanxhakut të Shkodrës në vitet 1485—1582*, Studime Historike, nr. 1, Tiranë, 1972, 125—127.

Familje „me dy fe” ka pasur shumë edhe në Karadak të Shkupit, përkatësisht në katundin Stubëll të Poshtme. Këto kanë qenë familje „laramane”, sepse në shtëpi mbanin fenë katolike, kurse jashtë ato deklaroheshin si myslimane. Kuptohet se në këto familje gratë kanë qëndruar më gjatë në fenë e vjetër të tyre, sepse ato nuk vinin në kontakt me botën e jashtme, kurse meshkujt kanë qenë në kontakt të përhershëm se myslimanët, kështu që kanë qenë të detyruar t’u përshtaten kushteve të mjedisit ku jetonin.

Në të kaluarën në Lug të Baranit mund të ketë pasur shumë familje dyfesh, sepse procesi i islamizimit ka përparuar gradualisht — më parë kanë ndërruar fenë meshkujt e pastaj femrat. Madje, edhe këta një kohë të gjatë vetëm me fjalë kanë qenë myslimanë, kurse me bindje kanë mbetur po ata që kanë qenë. Këtë dukuri edhe tash e ilustronjë mirë pleqtë me humorin e tyre kuptimplotë: kështu, njëherë vijnë në këto vise shokët e tyre të fisit nga disa fshatra më të largëta dhe kur shohin se këta nuk ishin bërë ende myslimanë, bëjnë presion në ta që ta ndërrojnë fenë sa më parë e të bëhen njësoj me kushërinjtë e tyre të fisit. Këta u thonë se do ta ndjekin she-mbullin e tyre dhe do t’ua bëjnë qejfin, por le të kenë durim deri në Shengjergj, sepse gjatë dimrit duhet t’i hanë derrat që i kanë therë. Këtë tregim e kallëzojnë edhe në vise të tjera. Në Karadak të Shkupit tregojnë se një fshatar „mysliman i ri”, i këtyre anëve, shkon për një punë, në kohë të turkut, në hyqymet në Gjilan, dhe kur e pyesin zyrtarët a është katolik, apo „turk”, ky përgjigjet: „Pasha Krishtin, turk, bile i fortë!” Kjo tregon se feja në masat fshatare nuk ka pasur rrënjë të thella, qoftë e vjetra, qoftë e reja. Këtë e vërteton edhe fakti se në një familje kanë ekzistuar dy fe. Kështu në Lug të Baranit deri tash vonë kanë qenë 2—3 familje të përziera: në Baran të Epërm familja e Smajl Keqanit dhe në Llugaxhi familja e Adem Tahirit. Këtë të fundit e kam vizituar më 1957, atëherë kur kjo përbëhej nga myslimanë e katolikë, të cilët ishin kushërinj të parë dhe jetonin në harmoni të plotë. Secila palë i respektonte zakonet e fesë së saj — myslimanët mbanin ramazanin dhe festonin bajramin, kurse katolikët mbanin krezhmet dhe festonin pashkët, kërshëndellat etj. Kurrfarë mosmarrëveshjeje nuk kishte në mes tyre, përkundrazi të dy palët tregonin mirëkuptim dhe respekt ndaj palës tjetër në raste të tilla. Më vonë kjo familje është ndarë. Përkatësia fetare nuk ka qenë shkak për ndarjen e saj, por, si te të gjitha të tjerat, arsyeja kryesore për ndarje ishte e natyrës ekonomike.

Në kushte të reja shoqërore dhe ekonomike edhe familja ka marrë rrugën e emancipimit si kudo në Kosovë, ashtu edhe në Lug të Baranit. Shkollimi i brezit të ri, mundësia për të hyrë në punë jobujqësore në qytet ose në shtete të jashtme si edhe dendësia gjithnjë më e madhe agrare, ndikojnë shumë në shthurjen e familjes patriarkale, sidomos në shthurjen e familjeve të mëdha. Dikur ndarja e familjes konsiderohej si një fatkeqësi e madhe, madje, edhe si turp dhe shkelje e traditës shekullore. Sot ndarja e familjeve është proces i zakonshëm dhe imperativ i kohës.

Ndjenja e solidaritetit ndërmjet pjesëtarëve të familjes së madhe patriarkale në të kaluarën ka qenë në shkallë shumë më të lartë se sot. Kjo për arsye se të gjithë merreshin me një lloj pune — me bujqësi, dhe nuk ka pasur mundësi që ndonjë nga pjesëtarët e saj të fitonte diçka jashtë kolektivit familjar me punën e tij individuale. Pasuria (prona) ka qenë e përbashkët, puna dhe rezultatet e saj — gjithashtu të përbashkëta. Pra, nga aspekti ekonomik, familja ka qenë një njësi kompakte, të themi — një trup. Megjithëse në Lug të Baranit familja gjithmonë ka qenë relativisht e varfër, prapë pjesëtarët e saj e ndienin vehten të sigurt, sepse ata përbënin një kolektiv kompakt, ku ndjenja e solidaritetit ekonomik etj. ka qenë frymëzim për punë e qëndresë edhe në situata të vështira qoftë ekonomike, qoftë edhe të llojit tjetër. Ky solidaritet dhe kjo kompaktësi në të kaluarën ka qenë e kushtëzuar edhe nga disa faktorë shoqërorë, përkatësisht nga rreziku i pasigurisë së njerëzve dhe i pasurisë nga organet e pushtetit ose nga individët. Në situata të tilla, një kolektiv i madh familjar, ku ka pasur shumë meshkuj të armatosur, nuk sulmohej aq lehtë.

Në kushte të reja shoqërore-ekonomike, janë zhdukur shumë faktorë të cilët më parë e mbanin kohezionin dhe solidaritetin familjar. Ata që mund të fitojnë nga puna e tyre individuale jashtë kolektivit familjar shohin se mund të jetojnë më mirë vetëm me familje të ngushtë të tyre. Nga ana tjetër, siguria e njerëzve dhe e pasurisë nuk rrezikohet si në të kaluarën dhe kështu janë zhdukur arsyet kryesore për të qëndruar në kolektive të mëdha, ku interesi individual shkrihet në interesin e familjes së madhe. Në Lug të Baranit në këtë drejtim rol të madh luan edhe fakti se kjo zonë ka dendësi të madhe agrare, e cila dita-ditës bëhet edhe më e madhe, sepse numri i njerëzve po rritet shpejt, por sipërfaqja e tokës pjellore mbetet ajo që është. Edhe ky faktor i rëndësishëm ndikon fort në dobësimin e solidaritetit familjar në kolektive të mëdha dhe në shthurjen e tyre.

**Fisi.** — Siç dihet në të kaluarën fisi ka luajtur rol të madh në jetën shoqërore-ekonomike ndër shqiptarë në viset malore të veriut ku këta kalonin jetë të pavarur nga pushteti shtetëror, por jetonin sipas normave të kanunit të maleve, të traditës dhe moralit patriarkal. Fisi përbëhej nga disa vëllezëri, kështu që të gjithë pjesëtarët e një fisi kanë qenë të lidhur me gjini gjaku, sepse të gjithë rridhnin nga një i parë i tyre i largët, ishin kushërinj në shkallë të ndryshme. Lidhja e gjinisë së gjakut ka qenë aq e fortë sa që martesat brenda fisit ka qenë e ndaluar, deri vonë ka mbretëruar ekzogamia në mes familjeve brenda fisit edhe atëherë kur këto nuk njiheshin fare, kur origjina e tyre e përbashkët ishte shumë e largët. Ndër ne kohezioni i fisit ka qenë shumë më i fortë se kohezioni fetar. Kështu, p.sh., myslimani i fisit Berishë e ka më të afërm katolikun po të këtij fisi, edhe atëherë kur këta nuk njihen fare ndër veti, sesa myslimanin të një fisi tjetër nga ka-

tundi i tij. Përveç gjinisë së gjakut, edhe shumë faktorë të tjerë kanë ndikuar në kohezionin dhe kompaktësinë e fisit, ndër të cilët territori i përbashkët, jeta ekonomike, organizimi i brendshëm dhe tradita në përgjithësi.

Në Rrafshin e Dukagjinit, dhe në Kosovë në përgjithësi, fisi as në të kaluarën nuk e ka luajtur atë rol të cilin e ka pasur në viset veriore të Shqipërisë, pastaj në disa vise të tjera malore, si p.sh., në Rugovë. Kjo, para së gjithash, për arsye se fisit në Kosovë i mungon një nga faktorët kryesorë me të cilin dallohet kjo bashkësi etnike e bazuar në — gjini gjaku dhe në territor të përbashkët. Në Kosovë pra, fisi nuk ka territor të përbashkët dhe nuk paraqet një kompaktësi në një hapësirë të caktuar, sepse pjesëtarët e një fisi janë të shpërndarë nëpër fshatra dhe vise të ndryshme, të përzier me fise të tjera. Mungesa e territorit të përbashkët, e kompaktësisë hapësinore, bën të pamundshëm aplikimin e normave të njohura kanunore mbi të cilat bazohet organizimi i fisit. Mirëpo, në disa vise malore, në Rugovë, në Shalë të Bajgorës etj., e gjithë zona etnografike përbëhet nga banorët e një fisi (i cili është i shpërndarë edhe në vise të tjera). Fisi në këto treva ka territorin e përbashkët — bjeshkën, kullotat, pyllin, pastaj rregulat fisnore sipas traditës, i përmbahen ekzogamisë dhe normave të tjera të traditës së fisit. Megjithatë, këtu jeton vetëm një pjesë e fisit, një numër relativisht i vogël i familjeve të fisit Shalë, përkatësisht Kelmend (në Rugovë). Raste të tilla, por në përmasa më të vogla, ka edhe në zonat fushore, ku një ose më shumë fshatra fqinj janë të një fisi. Kështu, p.sh. Isniqi, një ndër fshatrat më të mëdha në Kosovë (3400 banorë, më 1981) është vetëm Shalë; Strellci i Epërm (2800 banorë) — Krasniqe; Gadimja (2500 b.), pranë shpellës së njohur të kristaltë, afër Lipjanit, gjithashtu është Krasniqe, fshatrat e Vokshit janë Thaç, disa fshatra në Drenicë janë vetëm Berishë ose të fiseve të tjera e kështu me radhë. Mirëpo, në këto fshatra fushore, organizata fisnore vjen edhe më pak në shprehje se në viset malore që i përmendëm më sipër. Në kushte të reja ekonomike e shoqërore fisi në Kosovë e ka humbur gati krejtësisht rolin e kohezionit ndërmjet pjesëtarëve të tij edhe në fshat, kurse në qytet ka kohë që ky është zhdukur fare. Nga ky aspekt sot më shumë rëndësi ka përkatësia zonale, krahinore, sesa përkatësia fisnore.

Në Lug të Baranit edhe fisi ka disa veçanti më të theksuara sesa në disa zona të tjera fushore të Dukagjinit. Në të vërtetë, edhe këtu në shumicën e fshatrave fiset janë të përziara, madje në disa nga këto banorët u përkasin 4—5 fiseve të ndryshme. Mirëpo, edhe këtu në disa fshatra të gjithë banorët janë të një fisi, si p.sh., në Vranoc, Nepole e në Turjakë — Krasniqe, në Llugaxhi — gati të gjithë Berishë etj.

Ajo që është me interes për shqyrtimin e fisit në këtë trevë dhe që në jetën dhe në marrëdhëniet shoqërore në të kaluarën ka pasur peshën e vet — është fakti se këtu disa fise u përkasin

besimeve të ndryshme, përkatësisht fesë myslimane dhe fesë katolike. Këtu solidariteti fisnor në të kaluarën ka ardhur në shprehje në raste të ndryshme dhe ka pasur përparësi në krahasim me solidaritetin në bazë fetare. Kështu, p.sh., Krasniqja e Turjakës është e afërme me gjini gjaku me Krasniqen e Nepoles, megjithëse në Turjakë janë myslimanë kurse në Nepole të gjithë katolikë. Vranoci e Barani i Epërm gjithashtu janë të afërm nga ky aspekt me Turjakë e Nepole, sepse janë të një fisi. Berisha e Llugaxhisë, ku shumica janë myslimanë, janë të afërm me familjet katolike të këtij fshati, sepse edhe këto gjithashtu i përkasin fisit Berishë. Banorët e fshatit Gllogjan janë katolikë, shumica të fisit Berishë, dhe këta janë të afërm me gjini gjaku me Berishën në Llugaxhi, Çellopek, Kryshec etj.. edhe pse në këto fshatra popullsia është myslimane. Më në fund, në solidaritetin dhe kompaktësinë e fiseve të ndryshme të Lugut të Baranit ka ndikuar edhe organizata e bajrakut të kësaj zone, me qendër në Vranoc.

Përbërja fisnore e fshatrave të Lugut të Baranit (numri i familjeve të tyre) nuk mund të jepet me këtë rast krejtësisht e saktë, për arsye se regjistrimet zyrtare të popullsisë nuk e shënojnë këtë element dhe kështu nuk mund të shihet nga regjistrimi numri i familjeve të fiseve të ndryshme. Shënimet që i kam marrë nga bashkëbiseduesit në terren më 1951, 1972, 1979 dhe 1980 për këtë çështje kanë dhënë rezultate të ndryshme për të gjitha këto vite. Kjo ngjet edhe nga shkaku se ndarja e familjeve në kohët e fundit bëhet shumë shpesh e, përveç kësaj, shpërngulja e disa familjeve të vogla në qytet nuk është definitive, sepse një pjesë e saj shkon, kurse pjesa tjetër mbetet në fshat, ndërsa disa familje të tjera vijnë herëpashere në fshat e pas disa ditësh shkojnë përsëri në qytet, ose në punë të përkohshme në botën e jashtme. Për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të shtrirjes së fiseve në këtë zonë, këtu po japim një tabelë, e cila nuk është krejtësisht e saktë, por vetëm orientuese. Më në fund numri i familjeve ndryshon ditë-ditës me ndarjen dhe migrimin e tyre.

Si shihet nga të dhënat jo të plota në tabelën në fq. 108, Berisha dhe Krasniqja kanë më shumë shtëpi në këtë zonë, ku janë të përfaqësuara gati „dymbëdhjetë fiset”. Disa fshatra, edhe që nuk janë të mëdha, janë të banuara nga gjashtë fise (Barani i Poshtëm, Çellopeku dhe Kosuriqi), kurse Vranoci, Nepolja e Turjaka janë fshatra të një fisi (me përjashtim të 2 shtëpive në Turjakë).

Në të kaluarën, familjet që i takonin një fisi të madh kishin mbështetje morale në të, edhe atëherë kur këto ishin vetëm disa shtëpi në një fshat, sepse, në rast nevoje, gëzonin përkrahjen e shoqëve të fisit, qofshin këta edhe shumë larg. Këtë solidaritet fisnor e ilustron mirë edhe rasti i kullës në Turjakë nga fundi i shekullit të kaluar.

Kulla në Turjakë është një objekt interesant jo vetëm nga aspekti i arkitekturës popullore, por edhe nga ai historik. Ajo ka hyrë edhe në historinë e pashkruar të kësaj treve, por megjithatë të

**Pasqyra orientuese e përbërjes fisnore të Lugut të Baranit**  
(Numri i familjeve)

Fshati	Krasniqe	Berishë	Gash	Shalë	Kelmend	Bytyç	Thaç	Morinë	Mirditë	Kabash
Kryshec		50	30			11				
Rashiq	2	35		40		4				
Turjakë	40		2							
Baran i Epërm	22	5					2			
Baran i Poshtëm	12	12	30	8	5		1			
Kodradiq	32	5	22							
Vranoc	60									
Çellopek	15	30	3	5	12		5			
Broliq			25	20						
Kosuriq	12	17	50	10	30		25			
Buqan	2	10	30							
Llugaxhi	5	22								
Glllogjan		20					13		9	10
Nepole	42									
Çeskovë		15	5	2				15		
Kpuz	10	45								
<b>Gjithsej</b>	<b>254</b>	<b>266</b>	<b>195</b>	<b>85</b>	<b>47</b>	<b>15</b>	<b>48</b>	<b>15</b>	<b>9</b>	<b>10</b>

shënuar në folklorin e saj. Kjo kullë është ndërtuar më 1885 për t'i bërë ballë ushtrisë turke, e cila, me Vesel Pashën në krye, luftonte kundër kryengritësve shqiptarë në këto vise. Kryengritësit vendosin të luftojnë nga kullat kundër osmanllinjve, prandaj brenda javës e ndërtojnë një të tillë në Turjakë, në një fshat me pozitë të mirë strategjike në krye të Lugut të Baranit. Në këngën përkatëse popullore thuhet — „Ja dhanë besën Mon Avdisë, — ja dhanë besën në shuplakë — t'i mbarojmë kullat n'Turjakë”.<sup>17</sup> Kjo kullë ekziston edhe sot (1983), madje në gjendje shumë të mirë, megjithëse e ndërtuar prej qerpiçësh, në tre kate, por me mure të trasha 90 cm. Sipas traditës kullën e kanë ndërtuar tri fise të këtyre viseve — Berisha, Gashi e Krasniqja, me qëllim qëndrese jo vetëm kundër turqve, por edhe kundër Shalës së Isniqit, e cila donte të zaptonte tokë dhe pyje në truallin e fshatit Turjakë. Këto tri fise e shfrytëzonin kullën bashkarisht, — në katin e parë (përdhesë) rrinte Berisha, e cila ka pasur për udhëheqës Maxhun Nimanin, në katin e dytë Gashi, me Abdullah Hoxhën në krye, kurse nga kati i tretë mbrohej Krasniqja, e cila ka pasur si pris Isuf Jahë Krasniqin dhe

<sup>17</sup> Demush Shala, *Këngë popullore historike*, Prishtinë, 1973, 204.

Lahë Hysen Krasniqin.<sup>18</sup> Turjaka është fshat i vogël dhe nuk mund të mbrohej pa ndihmën e shokëve të tyre të fisit nga Nepolja ose Vranoci. Kështu me një rast, kur Isniqi me Shaban Sadikun në krye e sulmon Turjakën, këta shpejt lajmërojnë Nepolen dhe kështu 100 vetë të armatosur nxitojnë për t'i mbrojtur shokët e tyre. Këtë ngjarje rapsodi popullor e ka shënuar edhe me këto vargje — „Ky Pal Gjoka me 'i gjog plak — me dy hapa ra n' Turjakë, — niqind shokë i kish përmbas”...<sup>19</sup>

Fisi, si tërësi etnike, ka ruajtur solidaritetin dhe afinitetin e pjesëtarëve dhe kjo ka qenë ana pozitive e tij. Mirëpo, në relacion me fise të tjera, përkatësia fisnore shpeshherë ka qenë mollë grindjeje dhe shkak për konflikte të përgjakshme. Koha ka bërë të veten edhe në Lug të Baranit, kështu që kjo përkatësi edhe këtu ka marrë ngjyrën e „flakës së qirit”.

**Bajraku.** — Kur flasim për veçoritë etnografike të Lugut të Baranit, patjetër duhet të ndalemi në shqyrtimin e institucionit të bajrakut, i cili deri vonë ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën shoqërore të kësaj treve, madje dhe më gjerë, sepse Bajraku i Vranocit përfshinte edhe shumë katunde jashtë kësaj zone, përkatësisht territorin midis Bistricës së Pejës dhe Bistricës së Deçanit.

Turqit nuk ia arritën t'i pushtojnë fiset malësore me fuqinë e armëve, prandaj ata gjatë shekullit XVII filluan të emërojnë bajraktarë e të krijojnë bajraqe në Malësi, me qëllim që ta dobësojnë autoritetin e krerëve të fisit dhe fuqinë e tij. Bajraktarëve turqit u jepnin dhurata, rrogë e dekorata të ndryshme për të fituar miqësinë e besimin e tyre, ose, me fjalë të tjera, për t'i blerë në këtë mënyrë. Nga ana tjetër, bajraktari kishte për detyrë të marrë pjesë me njerëzit e bajrakut në luftëra të ndryshme që i bënte turku në Ballkan, ose më larg. Bajraku nuk përputhej gjithmonë me kufirin e fisit, kështu që mund të përfshinte një numër fshatrash të viseve kuvend të flamurit, kur të thirret, — „burrë për shpi” dhe të shko-milje.<sup>20</sup>

Në Kosovë pushteti turk ua ka dhënë titullin e bajraktarit (flamurtarit) disa familjeve zakonisht nëse ndokush nga meshkujt e saj është dalluar në luftë me trimëri kundër armikut. Familje bajraktarësh ka pasur në Kosovë relativisht shumë. Kjo ka mundësuar që në rast të nevojës, të mblidhet një numër sa më i madh i ushtarëve, sepse, si parashihet edhe me normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, secila familje e bajrakut (flamurit) ka pasur për detyrë të dalë në kuvend të flamurit, kur të thirret, — „burrë për shpi” dhe të shkojë „në ushtri të flamurit”. Në Dukagjin bajraku nuk i ka pasur të gjitha elementet organizative si në Malësi, ku organizimi i tij për-

<sup>18</sup> Kallëzim i Malë Shaban Krasniqit, pronar i tashëm (1983) i kullës në Turjakë.

<sup>19</sup> Si në fusnotën 17.

<sup>20</sup> *Historia e Popullit Shqiptar, I*, Prishtinë, 1968, 371.

caktohej edhe me normat e Kanunit të maleve. Atje, përveç bajraktarit, bajraku ka pasur krerët, djalërinë, kuvendin etj.<sup>21</sup>

Bajraku i Lugut të Baranit quhej Bajraku i Vranocit, sipas fshatit nga i cili ka qenë bajraktari. Familja e bajraktarit është e fisit Krasniqe. Kjo trevë, si thamë, përbëhet nga fise të ndryshme, por shumica e familjeve janë Berishë e Krasniqe. Bajraku i Vranocit përfshinte të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit dhe shumë fshatra të tjera jashtë kësaj zone. Kufiri i tij shkonte nga Bistrica e Deçanit nga jugu deri në Bistricë të Pejës në veri, kurse kah lindja kufizohej me Drinin e Bardhë e kah perëndimj me fshatrat: Dubovik, Broliq, Zillopek, Graboc, Gorozhdec e Logjë, kështu që përfshinte rreth 40 fshatra.

Familja e bajraktarit e ka fituar këtë titull nga autoritetet turke qysh nga Lufta e Moresë, rreth vitit 1684, në të cilën, sipas traditës, kanë marrë pjesë 3 meshkuj të kësaj familjeje. Dy nga këta 3 vëllezër kanë qenë ushtarë, kurse i treti, i cili quhej Mehmet Dedë Mrripa, shkon për t'i vizituar vëllezërit e tij. Atje ai mëson se pasha turk, komandant i ushtrisë, i kishte punët ngushtë, sepse pala kundërshtare i paska ofruar mejdanin, për të marrë fund lufta në këtë mënyrë. Mehmeti paraqitet vullnetarisht për mejdan dhe del fitues në atë dyluftim. Atëherë pasha ia jep Mehmetit titullin bajraktar. Autoritetet turke, me anë të Begollëve të Pejës, ia falin Bajraktarit të Vranocit fshatin Prapaqan si feud (ky fshat kufizohet me Lugun e Baranit), fshatin Brojë në Drenicë dhe në Bjeshkën e Hajlës në Rugovë, e cila atëherë ka qenë kullotë e malësorëve të Malësisë së Gjakovës. Nga fshatrat Brojë e Prapaqan familja e Bajraktarëve deri vonë merrte të dhjetën e prodhimeve bujqësore.<sup>22</sup>

Megjithëse turqit e kishin formuar institucionin e bajrakut si mbështetje të tyre ushtarake, bajraku organizohej dhe vepronte në baza të traditës zakonore të vendit dhe shumë më shpesh luftonte kundër turqve sesa përkrah tyre. Në periudhën e Lidhjes së Prizrenit qëndrimi i bajrakut në krahun e interesave kombëtare erdhi në shprehje më mirë se kurdoherë më parë. Por edhe më vonë, bajraku gjithmonë luftoi kundër pushtuesve dhe agresorëve të huaj. Kështu edhe Bajraku i Vranocit ka qenë ferrë në sy për pushtetin turk, për pushtetin e krajl Nikollës në kohën e pushtimit të këtyre viseve gjatë Luftës Ballkanike dhe për pushtetin antipopullor të Jugosllavisë borgjeze.

Bajraku., si thamë, ka pasur karakter ushtarak, sepse si i tillë u nevojitej turqve. Mirëpo, ai ka qenë gjithashtu institucion shoqëror. Madje, roli i tij në jetën shoqërore, në marrëdhëniet ndërnjerëzore, ndërfshtare etj. ka qenë shumë i madh, dhe rregullisht pozitiv, sepse përpiquej për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe të ngatërre-

<sup>21</sup> Shtjefën Konst. Gjeçovi, *Kannuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1933; B. Palaj, *Mbi Kanunin e maleve*, Studime e Tekste, Tiranë, 1944, 108.

<sup>22</sup> Kallëzim i Musli Krasniqit dhe i Beqir Krasniqit nga Vranoci.

save të ndryshme në territorin e tij. Rëndësia e tij ka qenë më e madhe mu në kohën e paqes, sepse atëherë ka pasur mision të posaçëm në rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet fshatrave dhe midis fiseve. Ndërhyrja e bajrakut, përkatësisht e bajraktarit, kërkohej atëherë kur shtereshin mundësitë e tjera për zgjidhjen e problemeve në instanca më të ulëta.

Në Kosovë rëndësia e bajrakut ka qenë e madhe për arsye se këtu nuk ka pasur organizatë fisnore — në shkallë të fisit, me territor të përbashkët në të cilin jetonte i gjithë fisi, me organet e vetëqeverisjes në bazë të normave të Kanunit të maleve. Bajraku në Kosovë nuk ka pasur organe të caktuara, siç ka pasur fisi, por bajraktari ka qenë kryet e punës. Në raste të ndryshme nuk kërkohej menjëherë intervenimi i bajrakut, por ekzistonte njëfarë rendi, kështu që më parë intervenonte vëllezëria, daja, kumbara, fqinjët, miqtë, shokët e fisit e dikur, nëse problemi ishte më i madh, kërkohej ndihma e bajraktarit, i cili, me pleqnarë të njohur, i jepte fund problemit të hapur.

Bajraku i Vranocit ka luajtur rol të madh në qetësimin e gjendjes së acaruar, e cila shpeshherë ka qenë në rend të ditës në lidhje me çështjet pronësore, rend të ujit, kullota, pyje, pastaj në lidhje me çështje të delikteve të ndryshme (gjakmarrje, rrahje, fyerje etj.), ose në lidhje me çështje të nderit, me ikjen e vajzave të fejuara etj. Rol të tillë ka luajtur Bajraku i Vranocit edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur gjithkush ka qenë i armatosur, kurse forca shtetërore në atë gjendje lufte, nuk kishte autoritet të nevojshëm. Problemet dhe ngatërresat e ndryshme që ishin grumbulluar me dhjeta vite më parë, tani kishin terren të përshtatshëm „për t'u zgjidhur” në mënyrë drastike, në bazë të normave mesjetare të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Kjo kohë ka qenë e përshtatshme edhe për lindjen e ngatërresave të reja. Me qëllim që t'u zihet shtegu rasteve të tilla, u formua në Kosovë Komisioni i Gjaqeve, ose „Islahati”, siç quhej në popull shpeshherë, për pajtimin e gjaqeve dhe zgjidhjen e ngatërresave të mëdha. Ky Komision ka pasur përkrahje të madhe të Bajrakut të Vranocit. Për të dhënë ndihmë sa më të madhe në këtë mision humanitar, ai më parë i rregulloi këto çështje në fshatrat që ndodheshin në terrenin e tij.

Bajraku i Vranocit nuk përfshinte popullsi heterogjene vetëm nga aspekti fisnor, por gjithashtu edhe nga aspekti fetar. Nga ky aspekt, shumë bajraqe të viseve të tjera, p.sh., në Drenicë, në Podgur, në Llap, në pllajën e Kosovës gati në përgjithësi, kanë qenë homogjene, jo të përziera. Por mu kjo përbërje heterogjene e Bajrakut të Vranocit, i jep këtij disa tipare të rëndësishme, rol të posaçëm në marrëdhëniet reciproke shoqërore në këtë zonë etnografike. Kjo shihet më mirë jo vetëm nga toleranca e plotë fetare ndërmjet myslimanëve e katolikëve, por nga fakti se kjo tolerancë ka qenë në atë shkallë saqë mund të quhet unitet i plotë. Këtë e vërtetojnë më mirë e më bindshëm rastet e disa familjeve që i përmendëm më sipër, në të cilat një pjesë e anëtarëve të tyre kanë

qenë myslimanë, kurse pjesa tjetër katolikë. Këta ishin vëllezër ose kushërinj të parë, njerëz të një shtëpie e të një sofere.

Kuptohet se për një unitet të tillë të pashoq nuk ka qenë arsye vetëm bajraku i përbashkët, sepse kanë ekzistuar disa faktorë të tjerë shoqërorë shumë të rëndësishëm, të cilët kanë pasur ndikim vendimtar në unitetin e myslimanëve dhe katolikëve në këtë trevë: ka qenë kjo, para së gjithash dhe mbi të gjitha, përkatësia kombëtare shqiptare e përbashkët — gjaku, gjuha, doket e zakonet, ndjenja dhe ndërgjegjja kombëtare, e kaluara dhe e tanishmja e përbashkët me të gjitha të mirat e të këqijat. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe pozita e tyre ekonomike dhe politike e vështirë dhe shumë e rëndë, njësoj për të gjithë, — si në kohën e feudalizmit turk, ashtu edhe gjatë sundimit të qeverive antipopullore midis dy luftërave të fundit botërore.

Solidariteti i bajrakut nuk shprehej vetëm në popullsinë shqiptare në territorin e tij. Si organizatë territoriale, bajraku ka pasur nën kujdesin e tij të gjithë banorët që jetonin në këtë territor. Në kohën e sundimit turk në Lug të Baranit nuk ka pasur asnjë familje sllave, sipas të dhënave të gjeografit serb Jovan Cvijiçit.<sup>23</sup> Mirëpo, në disa fshatra përreth tij ka pasur familje serbe dhe jevge të fesë ortodokse. Në rast nevojë, Bajraku i Vranocit edhe këto familje i merrte nën mbrojtjen e tij. Madje, ka pasur raste kur familjet serbe kërkonin ndërmjetësimin e bajrakut edhe atëherë kur këto kishin mosmarrëveshje dhe probleme ndërmjet veti.

Institucioni i bajrakut ka lindur në kushte specifike të sundimit feudal turk dhe ka vepruar derisa ekzistonin këto kushte. Me shkatërrimin e perandorisë osmane, përkatësisht me dëbimin e saj nga Ballkani më 1912, krijohen kushte të reja politike-shoqërore kur klasa sunduese nuk ka nevojë për përkrahjen e bajrakut, ashtu si ka pasur klasa feudale sunduese. Bajraku i Vranocit midis dy luftërave botërore megjithatë ekzistonte dhe zhvillonte një veprimtari mjaft aktive shoqërore — në pajtimin e ngatërresave në popull si edhe në organizimin e tij në planin politik — sidomos me rastin e votimeve për organe të ndryshme të pushtetit të atëhershëm.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndryshuan përsëri kushtet shoqërore-politike, u vendos rendi i ri socialist shoqëror, kur përkatësia e fisit dhe e bajrakut humbin krejtësisht rëndësinë e deriatëhershme të tyre, sepse funksionet që i kishte dikur bajraku, kalojnë në kompetencën e institucioneve shtetërore dhe shoqërore, kurse fisi në këto vise as më parë nuk ka qenë institucion i organizuar, siç ka qenë bajraku. Por fisi i ka rrënjët më thellë në traditën e popullit, sesa i ka bajraku. Fisi është një bashkësi e gjinisë së gjakut, pjesëtarët e tij rrjedhin nga prindërit e përbashkët (përveç rasteve kur një vëllazëri e huaj iu ka bashkuar fisit tjetër). Pra, të gjithë këta janë kushërinj mes veti, shumë të largët, por prapë — kushërinj. Nga ky aspekt fisi edhe sot është gjallë në fshatrat e

<sup>23</sup> Jovan Cvijiç, *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*, Beograd, 1911, 1189, 1190.

Kosovës. Bajraku, përkundrazi, ka qenë një institucion artificial, shpeshherë shumë heterogjen, kështu që, si i tillë, ai tash është qitur në harresë.

**Katundi.** — Si bashkësi shoqërore dhe ekonomike në një territor të përbashkët fshati ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin historik të çdo kombi, në çdo ambient gjeografik, para së gjithash si prodhues i gjërave ushqimore, por edhe si bazë e madhe e fuqisë punëtore dhe burim për plotësimin e detyrimeve të ndryshme ndaj shtetit. Kështu përcaktohej fshati qysh moti, nga aspekti i funksionit dhe i obligimeve të tij të jashtme — ndaj shoqërisë më të gjerë dhe ndaj shtetit. Mirëpo, katundi ka jetën e tij të brendshme, si komunitet i vogël, por me probleme të mëdha ekonomike dhe shoqërore, të cilat gjithmonë i ka rregulluar në bazë të normave të pashkruara të traditës popullore. Fshati ka organet e veta të qeverisjes së brendshme — kryeplakun, pleqtë e katundit dhe kuvendin e katundit, në të cilin merr pjesë me të drejtë të barabartë përfaqësuesi i secilës shtëpi. Madje, edhe në kohën romake e bizantine, fshati ka pasur organe të ngjashme, kurse kuvendi i katundit ka qenë sinonim i termit fshat.<sup>24</sup>

Disa fshatra të Lugut të Baranit përmenden qysh nga fillimi i shekullit XIV. Në mesjetë sundimtarët e ndryshëm u dhuronin kishave e manastireve të përmendura tokë, pyje dhe fshatra të tëra. Kështu vepronin edhe Nemanjiqët, sundimtarë serbë në këto vise në shekullin XIII e XIV, të cilët ua dhuronin fshatrat e Dukagjinit manastirit të Deçanit, patrikanës së Pejës, manastirit Hilandar në Greqi etj. Dokumenti që shkruhej me rastin e dhuratave të tilla quhej „krisobulë”, kurse prona që falej quhej „metoh” — pronë kishtarë, vakëf. Nga kjo fjalë greke vjen edhe emri Metohia në gjuhët sllave, i cili përdoret në vend të emrit Dukagjin. Në një krisobulë, me të cilën Stefan Urosh Nemanjiqi rreth vitit 1303 ia dhuron Hilandarit në Greqi disa fshatra në rrethinat e Pejës, përmenden edhe „dy Vranikët”. Si duket, këtu është fjala për „dy Vranocat” — Vranoci i Epërm dhe Vranoci i Poshtëm, sot fshat në Lug të Baranit.<sup>25</sup> Në një dokument të këtillë të mbretit Stefan Deçanski të vitit 1327, përmenden shumë fshatra të Lugut të Baranit: Kosuriqi, Çeskova, Çellopeku, Gllëgjani e Napolja. Pak më vonë, më 1330, kë krisobulën e Deçanit, përmenden Krysheci e Broliqi me rastin e përcaktimit të megjeve ndërmjet Prapaqanit dhe këtyre fshatrave. Me këtë rast përmenden Isniqi, Strellci, Lëbusha dhe shumë fshatra të tjera. Kështu, Krysheci kufizohej në atë kohë „me kronin e Dubovikut përtej rrugë”, kurse Broliqi me „rjedhën e ujit që derdhet në Bistricë” — siç thuhet në këtë krisobulë.<sup>26</sup> Duket se ka

<sup>24</sup> Stojan Novaković, *Selo*, Srpska književna zadruga, Novi Sad, 1943, 80.

<sup>25</sup> Riza, *Kosova gjatë shekujve.....*, 232.

<sup>26</sup> P. Ivić — M. Grković, *Dečanske hrisovulje...*, 157, 196, 197.

pasur grindje ndërmjet Hilandarit dhe manastirit të Deçanit rreth pronave të tyre në Lug të Baranit, çka shihet edhe nga krisobulat e dryshme të shekullit XIV.

Nga këto dokumente shihet mjaft qartë gjendja shoqërore-ekonomike e fshatarëve, të cilët kishin detyrime të ndryshme ndaj shtetit dhe ndaj kishës. Kështu, në krisobulën me të cilën mbreti Dushan Nemanjiq ia fal qelisë së Sveti Savës në Kare (Greqi) Kosuriqin me disa katunde të tjera të Lugut të Baranit, thuhet shprehimisht se të gjitha ato detyrime që këto fshatra i kanë pasur ndaj shtetit, tash e tutje do t'i kenë ndaj manastirit në fjalë, të cilit i falen këto fshatra me gjithë pasurinë e tyre (kopshte, livadhe, kullo-ta, mulinj etj.). Pra, siç shihet, fshatari ka qenë pronë e thjeshtë e huaj, punëtor i shfrytëzuar deri në fund nga kisha e nga shteti.

Të dhëna më të plota dhe më të rëndësishme për njohjen e kushteve shoqërore kah fundi i mesjetës në këtë trevë datojnë nga viti 1485, d.m.th. 155 vjet pas të dhënave që i përmendëm më sipër. Fjala është për defteret turke në të cilat janë regjistruar të gjithë kryefamiljarët dhe detyrimet e tyre, të gjithë meshkujt e moshës madhore të pamartuar dhe gratë e veja.<sup>27</sup> Të gjithë këta kanë qenë të ngarkuar me detyrime të ndryshme, qoftë ndaj shtetit me të holla (ispinxhe), qoftë me prodhime bujqësore (ushur), që zakonisht i mblidhte spahiu, i cili këtë të drejtë e kishte blerë nga shteti. Në këtë defter, përveç emrit të fshatit e të fshatarëve, përcaktohet shuma e të hollave dhe lloji e sasia e prodhimeve bujqësore, me të cilat ka qenë i ngarkuar fshati për t'i dorëzuar. Kështu ky defter jep një pasqyrë të qartë e të plotë mbi gjendjen ekonomike të fshatrave dhe mbi mënyrën e shfrytëzimit të tokës. Në defterin turk të vitit 1485 ka të dhëna për 9 fshatra të Lugut të Baranit: Kryshec, Buqan, Baran i Epërm, Baran i Poshtëm, Kodradiq, Gllongjan, Nepole, Kosuriq dhe Çeskovë. Pra, për dy të tretat të katundeve të sotme të kësaj zone kemi të dhëna të rëndësishme mbi gjendjen shoqërore dhe ekonomike të tyre para 50 vjetësh.

Po japim vetëm disa shembuj me të cilët ilustruhet jeta e fshatarit të kësaj treve. Kështu, fshati Kryshec në defterin e vitit 1485 figuron si vendbanim me 58 shtëpi (kryefamiljarë). Për atë kohë ky nuk ka qenë fshat i vogël, sepse atëherë popullsi ka pasur pak në përgjithësi. Përveç banorëve të tjerë, Krysheci ka pasur 19 beqarë e 3 të veja. Në regjistrin e kryefamiljarëve figurojnë 71 emra sllavë, 3 emra shqiptarë dhe 6 shiptarë e sllavë (baba shqiptar, djali sllav, ose e kundërta). Me këtë rast po e përsërisim edhe një herë atë që e thamë më parë, — se në atë kohë, dhe më vonë, shumë shqiptarë kanë pasur emra sllavë dhe, përveç kësaj, një pjesë e madhe e shqiptarëve edhe në Kosovë duhet të kenë qenë ortodoksë, nën juridiksion të kishës serbe — ortodokse; si të tillë edhe këta shqiptarë kanë pasur emra sllavë. Por ndër këta emra, sipas këtij defteri, në Kryshec edhe para 500 vjetësh ka pasur kry-

<sup>27</sup> S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit*..... f. XIX—XXIII.

efamiliarë shqiptarë, edhe me emër. Kështu në defter rreshtohen, p. sh., — Gjergji, i vëllai i Radiçit, Branko, i vëllai i Gjonit, Bozhidari, i biri i Nushës, Nenko, i biri i Gjurës, mysliman Hamza etj. Nëse Gjergji, Gjoni, Nusha etj. kanë qenë shqiptarë, atëherë kuptohet se edhe vëllezërit e tyre Branko, Radiçi, Bozhidari, Dimitri etj. kanë qenë të kësaj kombësie. Më në fund, si thamë edhe më parë, shqiptarët katolikë në Kosovë e në Mal të Zi edhe sot në shumë raste kanë emra sllavë; të tillë ka edhe në Pejë, në Lug të Leshanit, madje edhe në Lug të Baranit. Këto të dhëna nga defteri i shekullit XV tregojnë gjithashtu se emri i huaj, i cili ndër ne edhe sot praktikohet tepër shpesh, ka qenë dhe është gjithmonë i dëmshëm, sepse ai nuk e përcakton individualitetin integral të njeriut. Përkundrazi, shqiptari që mban emrin e huaj (emrin fetar — Avdyll, Avdi, Bajram, Baki, Mark, Martin, Marjan, Zyrafete, Zeqavete, Mari, Margaritë etj.) në këtë mënyrë fsheh përkatësinë e tij kombëtare, megjithëse ai nuk e ka këtë qëllim, as nuk është fajtor për mosdijen, ose indiferentizmin e prindërve të tij, të kushtëzuar nga ndikimi i dëmshëm i disa priftërinjve dhe hoxhallarëve, të cilëve emrat shqiptarë (Agim, Gëzim, Fatos, Fatmir, Hekuran, Ilir, Dritë, Shpresë, Liri, Ilire etj.) ua vrasin veshin, sepse janë të verbëruar nga fanatizmi fetar.<sup>28</sup> Është e vërtetë se emri nuk e bën njeriun as më të mirë as më të keq, kështu që edhe Keqani mund të jetë shumë njeri i mirë e pozitiv, kurse edhe Besniku mund të jetë person negativ dhe i pabesë, por emri duhet të ketë një kuptim në gjuhë tonë, sepse edhe ai është pjesë e kulturës sonë kombëtare, siç është në çdo popull.

Përveç çështjes së onomastikës, e cila është me interes edhe për shkencën e etnografisë, defteri jep për Kryshecin edhe shënime të tjera, kryesisht të natyrës ekonomike, të cilat në mënyrë të ndryshme ndikojnë në disa aspekte të kulturës popullore. Kështu, fshati ka qenë i detyruar të dorëzojë 26 barrë thekër, 25 barrë ujë, 15 barrë mel, një sasi bathë e li si edhe taksa për perime, fruta, bar, dru etj. Pra, përveç me dorëzimin e prodhimeve bujqësore të përmendura, fshati ka qenë i ngarkuar edhe me të holla (1543 ispenxhe) për prodhime të tjera të cilat nuk dorëzoheshin në natyrë.<sup>29</sup> Nga kjo shihet se fshatrat e Lugut të Baranit edhe atëherë, si sot, kishin në dispozicion sipërfaqe relativisht të mëdha livadhesh dhe komplekse pyjesh. Pyjet e fshatrave të kësaj treve tash nuk janë të atilla si mund të kenë qenë para 500 vjetësh, por sipërfaqet e mbuluara me kaçuba dhe drunj jo të lartë, as tash nuk janë të vogla. Taksat për bagëti paguheshin sipas një defteri të posaçëm, prandaj ato nuk përfshihen në këtë defter, kështu që, nëse nuk e kemi parasysh këtë fakt, mund të nxirren përfundime të gabuara për ekonominë e përgjithshme bujqësore të asaj kohe.

<sup>28</sup> M. Krasniqi, *Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike*, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, 377—414.

<sup>29</sup> S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit.....*, 241

Nga ekonomia e këtyre fshatrave bie në sy fakti se në defterin e vitit 1485 nuk përmendet misri si kulturë bujqësore, por vetëm gruri (si drith), i cili sot mbillet shumë më pak se misri. Por kultura e misrit, siç dihet, është sjellë në Evropë pas zbulimit të Amerikës më 1492 nga Kristofor Kolombi. Sot Krysheci është fshati më i madh në Lug të Baranit, më 157 familje, 1406 banorë (1213 shqiptarë, 179 malazez, 7 serbë e 7 myslimanë, në vitin 1981).<sup>30</sup>

Nga dokumentet që i përmendem më sipër shihet pra struktura ekonomike, sociale dhe deri diku struktura kombëtare, në bazë të antroponimeve. Mirëpo, në to nuk ka të dhëna mbi rregullimin e brendshëm të fshatit. Si duket, kuvendi i katundit ka traditë shumë të gjatë, si e cekëm edhe në fillim të shqyrtimit të kësaj teme. Fshati i Lugut të Baranit nuk dallohet nga fshatrat e viseve të tjera të Kosovës përkrah rregullimi i brendshëm, sepse institucionet tradicionale kanë qenë kudo njësoj. Kryeplaku, pleqtë e katundit dhe kuvendi i katundit janë institucione tradicionale. Mirëpo, në disa vise ka pasur edhe pleqnarë, njerëz të vjetër, me përvojë dhe të ndershëm, të cilëve palët në konflikt ua besonin problemin kontestues për ta zgjidhur sa më drejt sipas normave të Kanunit dhe ndërgegjes së tyre. Pleqnarë nuk ka pasur shumë, madje, ata kanë qenë mjaft të rrallë, kështu që në shumë zona etno-gjeografike nuk kishte fare dhe njerëzit udhëtonin mjaft larg për të arritur deri tek ata. Në këto vise si pleqnarë përmendet Povata i Strellcit të Epërm, Salih Rrusta në Deçan, Shaban Hoxha në Isnig dhe „dera” e Bajraktarit të Vranocit.

Institucionet tradicionale të vetëqeverisjes në katund veprojnë deri pas Luftës së Parë Botërore, kur këto zëvendësohen me „miftarin” ose „kmetin” e katundit, përkatësisht me kryeplakun, i cili ka qenë organ i administratës shtetërore. Por edhe atëherë, madje, edhe sot, ka pasur shumë raste kur nejrëzit u drejtoheshin pleqve të mençur për të zgjidhur probleme të ndryshme, duke evituar kështu procedurën gjyqësore ose administrative. Sot fshati ka këshillin e tij, zakonisht të përbërë nga tre anëtarë, njëri nga të cilët është kryetar i këshillit. Mirëpo, megjithatë, për gjëra të rëndësishme të përbashkëta vendosin të gjithë kryefamiljarët, pra, kuvendi i katundit.

Nga aspekti i veçorive etnografike të Lugut të Baranit këtu duhet të përmendim disa vendime të kuvendit të katundit në lidhje me ndryshimin e disa normave nga tradita popullore e kësaj treve. Kështu, më 1965 fshatrat e kësaj zone kanë lidhur „sull” që mos t’i fejojnë vajzat pa kryer shkollën tetëvjeçare. Ky vendim i jep fund traditës prapanike e cila lejonte prindërit për t’i fejuar vajzat edhe në djep. Ky është një hap i madh drejt emancipimit të femrës, sepse vajza e cila e kryen shkollën tetëvjeçare mund ta ketë fjalën e saj me rastin e fejesës, prindërit zakonisht e respektojnë dëshirën e saj, madje ajo shpeshherë vendos vetë me kë dëshiron

<sup>30</sup> Enti Krahinor i Statistikës, *Buletin* nr. 14, Prishtinë, korrik 1981, 40.

të fejohej, kurse prindërit pastaj vetëm i kryejnë formalitetet e rasti sipas zakonit. Lugu i Baranit ka lidhur sull (më 1965) me të cilin caktohet edhe shuma e të hollave që mund të merret për përgatitjen e pajës (çezit). Atëherë është vendosur që për këtë qëllim nuk mund të kërkojë miku më shumë se 5 milionë dinarë. Për atë kohë as kjo nuk ka qenë pak, mirëpo, dikush-dikush ia tepronte me kërkesa të mëdha, kështu që miku (prindërit e dhëndrit) binte në pozitë të keqe ekonomike. Përveç kësaj është ndaluar pagesa e „msitit” — dhënia e një sasive të vogël të hollash „hupse” prindërve të vajzës së fejuar. Ky zakon në të vërtetë edhe më parë praktikohet shumë rrallë, megjithëse ka pasur më tepër kuptimin e dhuratës dhe të kompenzimit të shpenzimeve që bëhen me rastin e përcjelljes së vajzës. Edhe zgjatja e dasmës është shkurtuar në saje të marrëveshjes së katundit. Madje, kjo tash nuk është karakteristike vetëm për një zonë etnografike, por për të gjitha viset, kështu që dasma kryhet brenda ditës — dasmorët vijnë në mëngjes, para dite e marrin nusen, hanë drekë dhe kah mbrëmja shpërndahen. Kuptohet, farefisi dhe miqtë e largët rrinë më gjatë.

Me sull të katundit është përcaktuar edhe koha sa duhet të zgjasë „e pamja”, ose ngushëllimet. Më parë gjatë gjithë vitit duhej të rrinte zoti i shtëpisë në shtëpi për të pritur njerëzit që mund të kenë dëgjuar më vonë për rastin e vdekjes dhe vinin për kryeshëndoshë kur kishin kohë, kështu që i zoti i shtëpisë humbte shumë kohë duke pritur vizita eventuale të miqve e dashamirëve. Në disa fshatra janë marrë vesh që edhe mënyra e shprehjes së ngushëllimeve të thjeshtësohet. Kështu, kur shkon një grup njerëzish nga një fshat ose nga disa fshatra për ngushëllime, atëherë ai që u prin, kur të ulen në dhomë të miqve i thotë zotit të shtëpisë: „Në emër tim e në emër të gjithë këtyre shokëve nga Lugu i Baranit (ose katundi përkatës), qofshi shëndoshë e paçi gajret”, ose fjalë të tjera të ngjashme të rasti. Të tjerët nuk flasin. Atje ku fshati nuk është marrë vesh ende për një ndryshim të këtillë, të gjithë me radhë i shprehin ngushëllimet, duke përsëritur thujtë të gjithë fjalët e njëjta.

Katundi në Lug të Baranit, si edhe në vise të tjera, vendos për shfrytëzimin e ujit me rend, për vaditjen e fushave, për zënie e livadheve në pranverë, për rregullimin e rrugëve etj., por të gjitha këto janë veprime të zakonshme dhe tash kryesisht në kompetencën e këshillit të katundit ose të bashkësisë lokale, nëse është fjala për ndonjë punë ose problem të përbashkët të disa fshatrave.

Ajo që në Lug të Baranit duhet të përmendet me këtë rast si veçori etnografike, përveç asaj që u tha më parë, është tradita e bajraktut, e cila krejtësisht është zhdukur në kushte të reja shoqërore si organizatë, ose institucion, mirëpo një numër njerëzish nga brezat e moshuar, në shumë raste për ndonjë problem të tyre kërkojnë pleqni nga „dera e Bajraktarit”, sidomos kur është puna e ngatërresave pronësore. Kështu problemi zgjidhet më shpejt dhe me më pak telashe. Por, ka raste kur për ngatërresa më të mëdha kër-

kojnë plak edhe jashtë Lugut të Baranit ose bashkohen disa pleq nga zonat e ndryshme.

Në fshatrat e kësaj treve ruhet ende tradita e mirë e ndihmës me punë krahu familjeve të vobekta dhe atyre që nuk kanë fuqi punëtore në shtëpi, por edhe familjeve të tjera që kanë nevojë për ndihmë të tillë, si p.sh., me rastin e ndërtimit të shtëpisë ose të ndonjë objekti tjetër, kur ndokujt i mbetet fusha pa punuar etj. Kjo është upria, zakon i vjetër i solidaritetit të fshatit, i njohur qysh moti ndër ne dhe ndër popuj të tjerë të Ballkanit. Fshatari e çmon fqin, për të cilin thotë se „është më i afërt se vëllau”. Nëse blen ndokush shtëpi, ai më parë pyet kush është fq i dhe çfarë njeriu është ai, pastaj pyet për çmimin e shtëpisë, sepse, thotë populli — „sa vlen shpia, vlen kojshia.” Kur ndahet familja patriarkale në disa pjesë, në disa vllazni, ata zakonisht ndërtojnë shtëpitë afër njëri-tjetrit dhe kështu, si vëllezër ose kushërinj, krijojnë një mëhallë të re ku fqinjësia e mirë përforcohet edhe me afërsinë e gjinisë së gjakut. Solidariteti familjar për fshatarin, fisnor dhe fqinjësor ka rëndësi të madhe për shumë arsye.

### Përfundim

Për fshatrat e Lugut të Baranit ka të dhëna të shkruara qysh nga fillimi i shekullit XIV, por me rëndësi të posaçme janë dokumentet turke të shekullit XV, në të cilat jepet një pasqyrë mjaft e qartë e kushteve shoqërore-ekonomike për shumicën e fshatrave të sotme të kësaj treve. Fshatarët kanë qenë bujkrobë, qoftë në pronat e manastireve të ndryshme, qoftë në ato të spahinjve osmanë, deri pas Luftës së Parë Botërore. Por edhe në kohën e sundimit të Jugosllavisë borgjeze fshatari shqiptar i kësaj zone, si në gjithë Kosovën, ka qenë i shtypur, i shfrytëzuar dhe i persekutuar, pa kurrfarë të drejtash qytetare. Kushtet e tilla shoqërore-ekonomike kanë ndikuar që në jetën dhe në organizimin e familjes, të fisit, të bajrakut dhe të fshatit të ruhen dhe të gjallojnë shumë norma nga tradita jonë popullore, të cilat këtu i kanë edhe disa veçori etnografike.

Familja në Lug të Baranit edhe sot ka ruajtur shumë tipare të familjes patriarkale. Madje, në disa fshatra edhe tash ka familje të mëdha me nga 20 deri 40 pjesëtarë. Për familjen e kësaj treve si veçori specifike ka qenë, deri në ditët tona, fakti se në disa fshatra ato kanë qenë të përziera nga aspekti fetar — një numër pjesëtarësh kanë qenë myslimanë, pjesa tjetër katolikë, megjithëse këta ishin vëllezër ose kushërinj të parë. Ka pasur deri para pak vjetësh edhe familje „të ndara”, — një pjesë e saj jetonte në Lug të Baranit, kurse pjesa tjetër në Voksh, ose në ndonjë zonë tjetër, por megjithatë këto familje përbënin një bashkësi ekonomike, me një kryefamiljar. Tani, në kushte të reja, kur rinia shkollohet dhe shumë njerëz punojnë, familja patriarkale fa filluar të shturet dhe kë-

shtu të krijohen familje të vogla individuale.

Fisi ka luajtur njëfarë roli edhe në këtë trevë, kur kushtet shoqërore-politike, pasiguria personale edhe e pronës, imponte nevojën e solidaritetit me qëllim vetëmbrotjeje. Shumica e banorëve janë Berishë e Krasniqe, por ka edhe Shalë, Thaç, Kelmend, etj., të besimit mysliman dhe katolik. Afiniteti dhe solidariteti në mes njerëzve të një fisi, por të feve të ndryshme, ka qenë shumë më i madh se në mes njerëzve të një feje, por të fiseve të ndryshme. Toleranca fetare shihet shumë qartë edhe nga fakti se këtu ka pasur edhe familje të përziera nga aspekti fetar.

Bajraku i Vranocit ka luajtur në të kaluarën rol të madh në jetën shoqërore të kësaj zone, qoftë si organizatë ushtarake, e cila i bashkonte rreth 40 fshatra për t'u mbrojtur nga ushtria turke, qoftë si institucion shoqëror, i cili në bazë të normave të traditës popullore ndërhynte për të zgjidhur ngatërresa dhe probleme të ndryshme në terrenin e tij. Kuptohet se në kushte të reja shoqërore e politike, që nga Lufta e Parë Botërore e deri më sot, fisi dhe bajraku në këtë trevë, si kudo ndër ne, janë zbehur krejtësisht dhe nuk luajnë kurrfarë roli publik, madje as në jetën private, përkatësisht në botëkuptimin e gjeneratave të reja.

Katundi si bashkësi ekonomike territoriale është institucion i lashtë dhe ka pasur organizimin e brendshëm shumë të ngjashëm me të gjithë popujt ballkanikë, kuptohet, me disa veçori të krijuara nga kushtet specifike kombëtare ose krahinore. Lugu i Baranit është një tërësi etnogjeografike me 15 fshatra, ku kushtet natyrore dhe ato shoqërore janë të përbashkëta për të gjitha këto vendbanime, kështu që edhe fshati ka pasur gjithmonë tiparet e njëjta, zhvillimin dhe rregullimin e përbashët, në bazë të traditave, të cilat gjatë shekujve kanë ndryshuar fare pak. Pleqtë e katundit, e sidomos kuvendi i katundit, shekuj me radhë ka qenë institucioni më autoritativ i fshatit edhe në këtë trevë. Fshati ka marrë edhe pas Luftës së Dytë Botërore disa vendime („sulle”) me të cilat luftohen disa zakone prapanike. Ndërsa fisi e Bajraku i takojnë së kaluarës, tradita e fshatit edhe sot është e pranishme, por e modifikuar sipas kushteve të realitetit të sotëm.<sup>31</sup>

<sup>31</sup> Mark Krasniqi, *Lugu i Baranit — Monografi etno-gjeografike* — dorëshkrim, f. 1—202. Të dhënat për këtë punim pjesërisht janë shfrytëzuar nga ky dorëshkrim, i cili u pranua për shtyp në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës më 21. III 1983.

*Mark Krasniqi*

QUELQUES PARTICULARITÉS ETHNOGRAPHIQUES DE LA VALLÉE  
DE BARAN

(Famille — clan — bajrak — village)

Résumé

La vallée de Baran est une région ethno-géographique dans les environs de Pejë; elle comprend 15 villages et s'étend dans la vallée de la Bistrica de Deçan depuis le village de Kryshec jusqu'au déversement de la rivière dans le Drin blanc. Selon les résultats du recensement de l'année 1981, la vallée de Baran compte 1124 habitants dont 10702 (95,35%) sont albanais, 413 (3,67%) monténégrins, 75 (0,66%) musulmans de nationalité, 25 (0,22%) serbes et 5(0,04%) d'autres nationalités. Plus de 25% de la population est rurale, tandis qu'environ 450 personnes travaillent temporairement à l'extérieur du pays (1981). La densité de la population rurale est donc très élevée on compte 25 ares de terre cultivable par habitant. L'agriculteur n'est pas en mesure d'assurer l'approvisionnement en pain pour l'année compte tenu de sa petite propriété.

A Lug de Baran, aujourd'hui encore la famille a conservé de nombreux traits caractéristique de la grande famille albanaise patriarcale. Dans certains villages il existe des familles de 20 à 40 membres; cependant les conditions nouvelles sociales et économiques font que les familles de ce type se désintègrent rapidement. Jusqu' à une époque récente il y a eu des familles mélangées en ce qui concerne l'aspect religieux; certains membres d'une même famille (frères et cousins) étaient musulmans d'autres catholiques. Il existait aussi des familles séparées dont une partie des membres vivaient à Lug de Baran, tandis que l'autre était établie dans une région plus lointaine et possédait aussi une propriété personnelle.

La plus grande partie des habitants font partie du clan des Berisha et des Krasniqi, mais il y a aussi d'autres clans (Gash, Kelmend, Thaç ect.) Ces clans sont à la fois de confession catholiques et musulmane. L'appartenance à la tribu lie davantage les hommes de cette région que l'appartenance religieuse. Les monténégrins sont des colons venus autour des années 1930 du Monténégro, parmi eux on distingue la tribu des Vasojevic, Kuq ect. Le registre turc du sandjak de Shkodër datant de 1845 (qui inclut aussi Peja et ses environs) montre que la population de Lug de Baran a été mélangée slaves et albanais.

Dans cette région ont aussi existé les regroupements en bajrak, comme on sait les turcs ont organisé le système de l'organisation en bajrak dans un but militaire; cependant le bajrak a lutté davantage contre l'armée turque qu'il ne l'a soutenue. Le rôle du bajrak était très important autant en temps de paix qu'en temps de guerre. Surtout dans la Kosova il a eu une influence dans la solution de divers problèmes sociaux, dans le dénouement des intrigues, dans la réconciliation des familles ennemies ect. L'organisation en bajrak a été établie sur un principe territorial, à sa tête se trouvait un chef (bajraktar). A Lug de Baran le bajrak est appelé Bajrak de Vranoc, nom du vi-

llage d'où était originaire le chef. Il comprenait environ 40 villages. Tous les habitants du village qui habitaient sur son territoire jouissaient de sa protection sans distinction d'appartenance nationale ou religieuse. Après la première guerre mondiale le bajrak n'a joué aucun rôle public.

Le village comme on sait, est une ancienne institution ayant un territoire commun et un règlement de vie sociale sur la base de quelques normes inspirées par la tradition populaire. L'organe le plus élevé autogestionnaire du village était l'Assemblée du village (Kuvendi i katundit) où participaient les représentants de toutes les familles du village. A Lug de Baran, bien qu'il jouisse d'une organisation établie sur la base des règlements de l'Etat et de la société socialiste, le village a tout de même gardé quelques normes de la tradition ancienne. Ainsi, par exemple les habitants ont décidé eux mêmes unaniment d'abolir certaines coutumes arriérées concernant les fiançailles de la jeune fille, qui maintenant ne peuvent se faire avant qu'elle n'ait terminé l'école primaire de huit années; ils ont de même raccourci la cérémonie du mariage qui auparavant durait quelques jours, tandis que maintenant elle s'accomplit en un jour.

The first part of the report is devoted to a general survey of the work done during the year. It is divided into three main sections: the first dealing with the work of the various departments, the second with the work of the various committees, and the third with the work of the various societies.

The second part of the report is devoted to a detailed account of the work of the various departments. It is divided into three main sections: the first dealing with the work of the various departments, the second with the work of the various committees, and the third with the work of the various societies.

The third part of the report is devoted to a detailed account of the work of the various committees. It is divided into three main sections: the first dealing with the work of the various committees, the second with the work of the various societies, and the third with the work of the various departments.

The fourth part of the report is devoted to a detailed account of the work of the various societies. It is divided into three main sections: the first dealing with the work of the various societies, the second with the work of the various departments, and the third with the work of the various committees.

The fifth part of the report is devoted to a detailed account of the work of the various departments. It is divided into three main sections: the first dealing with the work of the various departments, the second with the work of the various committees, and the third with the work of the various societies.